REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQESISE PYLLTARISE DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive
Nr./Br./No. 1627
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 777
Data/Datum/Date: 2/07/08
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLPJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

# UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.25/2008
## PËR RIPRODHIMIN E KAFSHËVE

ERSHOR – 2008
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLPJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19 të datës 13 Shtatorë 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 1 paragrafi 1.3 , pika (d) dhe nenit 5 (a) të Ligjit për Blegtorinë e Kosovës UNMIK/REG/2004/39 datë 14 tetor 2004,

Miraton:

# UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 25/2008 PËR RIPRODHIMIN E KAFSHËVE

## Neni 1

## Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohet licencimi i importuesve të materialit biologjik, kushtet e ruajtjes, procedurat e importit, kontrolli dhe certifikimi i materialit biologjik që përdoret për riprodhimin e kafshëve, evidentimi i materialit biologjik që vihet në qarkullim, licencimi i mbarësuesve artificialë si dhe certifikimi i demave që përdoren për riprodhim natyral.

## Neni 2

## Definicionet

Definicionet në vazhdim për qëllimet e këtij udhëzimi administrativ kanë këtë domethënie:

- **Riprodhim**, aftësi për përtëritjen e gjeneratave të reja përmes shumimit,
- **Dem për riprodhim**, demi i cili plotëson vetitë racore, fiziologjike dhe riprodhuese për mbarsim natyral,
- **Ambulanca veterinare**, qendra e licencuar për mbarësim artificial,
- **Mbarësuesi artificial,** fermerët, teknikët e veterinarisë dhe veterinerët e licencuar nga ministria për realizimin e mbarsimit artificial,

- **Importues i materialit biologjik,** personi fizik dhe juridik i licencuar për importin e materialit biologjik.
- **QKMK,** Qendra e Kosovës Për Mbarështim të Kafshëve.

KAPITULLI I

**Neni 3**

**Licencimi i importuesve të materialit biologjik**

3.1. Personat fizik dhe juridik të cilët aplikojnë të licencohen për importim të materialit biologjik duhet të plotësojnë këto kushte:

a) Të ketë të regjistruar veprimtarinë,
b) Të posedoj hapësirën për vendosjen e pajisjeve për ruajtjen e materialit biologjik,
c) Të ketë pajisjet për transportin dhe ruajtjen e materialit biologjik dhe
d) Të ketë personelin me përgatitje profesionale, veteriner ose teknik të veterinës, për mbikëqyrjen e materialit biologjik.

**Neni 4**

4.1. Licenca lëshohet për periudhën 2 vjeçare me mundësi vazhdimi.
4.2. Për kërkesën e licencës pronari paguan 100 €
4.3. Pagesa bëhet në Buxhetin e Kosovës.

**Neni 5**

**Aprovimi i importit të materialit biologjik**

5.1. Ministria bënë aprovimin e importit të materialit biologjik.
5.2. Importuesi i materialit biologjik aplikon për lejimin e importit. Aplikuesi për importimin e materialit biologjik duhet të paraqitet pranë Qendrës Kosovare për Mbarështimin e Kafshëve si në Aneksin I, që është pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ.
5.3. Importuesi i materialit biologjik duhet të paraqes certifikatën mbarështuese (pedigrenë).
5.4. Importuesi i farës duhet ti paraqes QKMK-së të dhëna për performancën e demit.
5.5. Importuesi është i obliguar të paguaj taksen e lejimit për importin e materialit biologjik ne shumë prej **5 €.**
5.6. Taksa paguhet në xhirollogarinë e Buxhetit të Kosovës.
5.7. Ministria me vendim përcakton çmimorën për testimet e ngarkesave për import me material biologjik.

**Neni 6**

6.1. Importuesit e materialit biologjik, duhet të mbajnë regjistrin e materialit biologjik.
6.2. Regjistri i materialit biologjik është unik dhe përmban këto të dhëna:

a) Data e realizimit të importit,
b) Sasia e materialit biologjik sipas racës dhe llojit,
c) Origjina e vendit të importit,
d) Numrin serik të dozave.

6.3. Regjistri i shpërndarjes së materialit biologjik është unik dhe përmban këto të dhëna:

a) Emri dhe mbiemri i mbarësuesit,
b) Adresa,
c) Numri i licencës,
d) Sasia e farës sipas racës,
e) Numri serik i dozave dhe
f) Data e vënies në qarkullim.

**Neni 7**

**Standardet e fertilitetit të farës**

7.1.Ministria ka aprovuar këtë standard për fertilitetin e farës së demave:

| **Emërtimi** | **Kategoria** | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Vlerësimi:** | **5** | **4** | **3** | **2** |
| **Vlerësimi i lëvizjes së spermatozoideve (%):** | **90** | **80** | **60** | **40** |

**Neni 8**

8.1. Ndalohet vënia në qarkullim e ngarkesës së farës nëse testi i cilësisë për vlerësimin e fertilitetit nuk është i mirë ose shumë i mirë ( 80 – 90 %).
8.2. Në raste tjera, importuesit i hiqet certifikata për shfrytëzim të mëtutjeshëm të kësaj ngarkese të farës dhe QKMK-ja merr vendim për asgjësimin e farës.

**Neni 9**

**Licencimi i Mbarësuesve Artificial**

9.1. Të gjithë personat fizik dhe juridik që merren me mbarsim artificial, duhet ti nënshtrohen trajnimeve të cilat organizohen nga QKMK.
9.2. Mbarësuesit pajisen me licencë të aftësisë profesionale për mbarsim.
9.3. Kjo licencë lëshohet nga QKMK, e miratuar nga Ministri.
9.4. Trajnimet organizohen në tre module:
a) Modulit të parë të trajnimit, kanë të drejtë t'i nënshtrohet të gjithë fermerët që merren me mbarështimin intensiv të kafshëve dhe që kanë më së paku 10 njësi gjedhi (lopë qumështore).
b) Modulit të dytë të trajnimit, janë të obliguar t'i nënshtrohet të gjithë personat që merren me mbarsim artificial që kanë të mbaruar shkollën e mesme profesionale të veterinarisë dhe
c) Modulit të tretë të trajnimit i nënshtrohen personat që merren me mbarësim artificial që kanë të mbaruar Fakultetin e veterinarisë.

**Neni 10**

10.1. Kushtet për licencimin e teknikëve të veterinës dhe veterinerëve janë:

a) Të kenë diplomën për përgatitjen shkollore përkatëse,
b) Të kenë pajisjet e nevojshme për ruajtjen, transportin e materialit biologjik dhe pajisjet për mbarsim.
c) Të kenë biznes të regjistruar dhe / ose ambulantë veterinere të licencuar.

10.2. Teknikët e veterinarisë dhe veterinerët e licencuar për mbarsim janë të obliguar të paguajnë shumën e licencimit prej 50 € .
10.3. Pagesa bëhet në Buxhetin e Kosovës.
10.3. Fermerët janë të liruar nga pagesa.

## Neni 11

Fermerët e licencuar kanë të drejtë të bëjnë mbarsimin vetëm në fermën e vet.

## Neni 12

12.1. Mbarësuesit artificial të licencuar mbajnë evidencën e mbarsjes.
12.2. Evidenca e mbarsimit është unike dhe përmban këto të dhëna:

a) Pronarin dhe adresën,
b) Numrin e regjistrit të fermës,
c) Numrin matrikulues dhe raca,
d) Datën e mbarsjes,
e) Të dhënat mbi demin dhe
f) Emrin, mbiemrin e mbarësuesit dhe numrin e licencës.

12.3. Evidenca e mbarsimit mbahet në tri kopje. Një kopje për pronarin, një kopje për mbarësuesin dhe një kopje për QKMK.
12.4. Të dhënat e evidencës regjistrohen në Regjistrin e mbarsimit. Regjistri është unik dhe përmban të dhënat e njëjta si në paragrafin 1 të këtij neni. Të dhënat e regjistrit ruhen më së paku 5 vjet.

## Neni 13

13.1 Ministria për vlerësimin e suksesit te mbarësuesve artificial ka përcaktuar indeksin 2.0 si pragun me te ulët për vlerësim pozitiv.
13.2 dështimet e mbarsimit artificial tek mbarësuesit e licencua nga indeksi i përcaktuar në pikën 13.1 janë te lejuara deri në minus 10 %.

## Neni 14

## Licencimi i demave për riprodhim natyral

QKMK bënë vlerësimin e demave për riprodhim natyral. Vlerësimi i demave bëhet në moshën 12 muajshe.

## Neni 15

QKMK përcakton kriteret e vlerësimit të demave për riprodhim, sipas racës dhe cilësisë së farës.

**Neni 16**

16.1. QKMK mbanë regjistrin e demave që shfrytëzohen për riprodhim natyral.
16.2. Regjistri përmban këto të dhëna:

a) Pronari i demit dhe adresa,
b) Numrin matrikulues dhe raca,
c) Datën e lindjes,
d) Të dhënat për origjinën,
e) Datën e testimit fillestar,
f) Data e futjes në reproduksion dhe
g)Datën e ritestimit sipas radhës.

**Neni 17**

17.1. Pronari i demit që shfrytëzohet për mbarsje natyrale duhet të mbajë këto të dhëna:

a) Emrin, mbiemrin dhe adresën,
b) Datën e shërbimit,
c) Nr. i matrikulës së lopës dhe
d) Raca.

**Neni 18**

18.1 Mos respektimi i këtij Udhëzimi Administrativ sanksionohet sipas nenit 25, paragrafi 25.1, pika (c) dhe (f) te Ligjit për Blegtorinë e Kosovës,
18.2 Përveç masës ndëshkimore sipas paragrafit 1 të këtij neni, hiqet edhe licenca për importuesin e materialit biologjik dhe mbarësuesve artificial.
18.3 Licenca sipas paragrafit 2 të këtij neni i tërhiqet edhe fermerëve te cilët mbarësojnë kafshë jashtë fermës se tij.

Neni 19

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit .

Prishtinë, 07. 07 2008

Ministria e Bujqësisë, pylltarisë
dhe zhvillimit rural,
Ministri
Idriz Vehapi

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLPJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

### KËRKESË PËR IMPORTIN E MATERIALIT PËR RIPRODHIM / KAFSHË

Nr. __/__

| |
|---|
| Emri dhe mbiemri: |
| Emri i subjektit: |
| Adresa: |
| Tel. Fax. E-mail: |

| |
|---|
| Raca: |

| |
|---|
| Sasia: |

| | | |
|---|---|---|
| Sasia sipas gjinisë: | Meshkuj: | Femra: |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Mosha: | Prej: | muaj | Deri: | muaj |

| |
|---|
| Shteti i Origjinës: |

| | |
|---|---|
| Importuesi: | Nr. i licencës |

| |
|---|
| Marrësi i dërgesës: |
| Adresa: |

Data:___/ ___/ ________ Nënshkrimi:________________

| |
|---|
| Sipas nenit 5 pika 5.2 të Udhëzimit Administrativ MA-NR. XX / 2008 bashkangjitur me kërkesën për importin e materialit biologjik duhet të jenë edhe certifikatat mbarështuese / pedigretë e kafshëve. |

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLPJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

## KËRKESË PËR IMPORTIN E MATERIALIT PËR RIPRODHIM / FARË

Nr. __/__

Emri dhe mbiemri:

Emri i subjektit:

Adresa:

Tel. Fax. E-mail:

Raca:

Sasia:

Numrat serik: Prej: Deri:

Viti i prodhimit

Shteti i Origjinës:

Importuesi: Nr. i licencës

Marrësi i dërgesës:

Adresa:

Data:___/ ___/ ________ Nënshkrimi:________________

Sipas nenit 5 pika 5.2 të Udhëzimit Administrativ MA-NR. XX / 2008 bashkangjitur me kërkesën për importin e materialit biologjik duhet të jenë edhe performanca e demit.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive
Nr./Br./No. 1627
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 7+7
Data/Datum/Date: 2/07/08
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLPJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

# ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO.25/2008
## ON THE ANIMAL INSEMINATION

**JUNE – 2008**
**PRISTINE**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLPJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

The Minister of Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development taking into account the UNMIK Regulation No. 2001/19 dated on 13 September 2001 on the Executive Branch of Provisional Institution of Self Government in Kosovo, article 1 paragraph 1.3, point (d) and the article 5 (a) of the Law on Kosovo Livestock UNMIK /REG/2004/39 date 14 October 2004,

Approves the following:

# ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO. 25/2008 ON THE ANIMAL INSEMINATION

## Article 1

## Purpose

The present Administrative Instruction regulates the license for importers of biological material, conditions of conservation, procedures of the import, control and certification of biological material that is used for the animal insemination, evidence of the micro biological material that is put into the circulation, the license of the artificial inseminators as well as certification of the bulls that are used for a natural insemination.

## Article 2

## Definitions

Definitions in the continuation for the purposes of this administrative instruction have the following meaning:

- **Insemination -** skill for the renewal of new generations through the insemination,
- **Insemination bull –** the bull that meet the race, physician and reproduction features for a natural insemination,
- **Vet ambulance –** the license center for the artificial insemination,
- **Artificial insemination –** farmers, veterinary technical and veterinarians licensed by the ministry for realizing the artificial insemination,

- **Biological material importers –** natural and legal person licensed for import of biological material.
- **KCAB**, Kosovo Center for the Animals Breeding.

## CHAPTER I

### Article 3

### License of importers for biological material

3.1. Natural and legal persons that apply to be licensed for import of biological material should meet the following terms:

a) Having registered the activity,

b) Possessing a space for the placement of equipments for the preservation of the biological material,

c) Having equipments for transport and the preservation of the biological material and

d) Having qualified staff, veterinary or veterinary technical for supervision of the biological material.

### Article 4

4.1. The license is issued for a period of 2 years with a possible extension.
4.2. For the license request the owner pays 100 €
4.3. Payment is done in Kosovo Budget.

### Article 5

### Approval of import for the biological material

5.1. The Ministry gives approval to the biological material import
5.2. Importer of the biological material applies for permission of an import. Applicant for import of the biological material must be presented under Kosovo Government for the Animal Breeding like in Annex I that is compound part of this Administrative Instruction.
5.3. Importer of the biological material must presents breeding certificate (pedigree).
5.4. Importer of the seed must present data to the Animal Breeding Center for the performance of the damage.
5.5. Importer is obliged to pay a tax of the permission for import of the biological material in the amount of 5 **€.**
5.6. Tax is paid into account of Kosovo Budget.
5.7. The Ministry upon the decision specifies the price list of the consignment tests for import with the biological material.

### Article 6

Importer of the biological material must keep records of the biological material.
6.1. Register of the biological material is unique and contents the following data:

a) Date of import realization,
b) Quantity of the biological material according to race and type,
c) Origin of import place,
d) Doses serial number.

6.2. The distribution register of the biological material is unique and contents the following data:

a) Name and surname of the inseminator,
b) Address,
c) The license number,
d) Quantity of the seed according to race,
e) Doses serial number and
f) The circulation date.

### Article 7

### The standards of the seeds fertility

7.1. The Ministry has approved this standard for the fertility of the bull's seed:

| Denomination | Category | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Assessment:** | **5** | **4** | **3** | **2** |
| **Assessment of the movement of spermatozoids (%):** | **90** | **80** | **60** | **40** |

### Article 8

8.1. It is stopped putting into circulation of the seed, if a test of quality for assessment of the fertility is not good or very well (80 – 90 %).
8.2. In the other cases a certificate for further use of this seed consignment shall be get out to the importer and Animal Breeding Center of Kosovo takes the decision for the destruction of the seed.

### Article 9

### The license of Artificial Inseminators

9.1. All natural and legal persons that are dealing with artificial insemination should be subject to trainings organized by the Animal Breeding Center of Kosovo.
9.2. Inseminators are equipped with the license of vocational trainings for the insemination.
9.3. This licensee is issued by the Kosovo Animal Breeding Center and approved by the Minister.
9.4. Trainings are organized in three modules:

a) All farmers that are dealing with the animal intensive insemination and at least having 10 cattle units (diary cows) are subject to the first module of training.

b) All persons that are dealing with the artificial insemination and finished professional secondary school of veterinary are obliged to be subject to the second module and

c) Persons that are dealing with the artificial insemination graduated of Veterinary Faculty are subject to the third module.

### Article 10

10.1. Terms of the license of veterinary technicians and veterinarians are as follow:

a) Having a diploma of a relative education,

b) Having necessary equipments for the preservation, transport of the biological material and equipments for insemination.

c) Having the registered business and /or the license veterinary ambulance.

10.2. Veterinary technicians and the license veterinarians for the insemination are obliged to pay the amount of the license of 50 €.

10.3. A payment is done in Kosovo Budget.

10.3. Farmers are released from the payment.

### Article 11

The licensed farmers have the right to do the insemination only in its farm.

### Article 12

12.1. The licensed artificial inseminators must keep records for the insemination.

12.2. Evidence of the insemination is unique and contents the following data:

a) The Owner and address:
b) Number of the farm register,
c) An identification number and race,
d) The date of insemination,
e) The data on the bull and
f) Name and surname of the inseminators and number of the license.

12.3. Evidence of the insemination is kept in three copies: One copy for the owner, one copy for the inseminator and one copy for the Kosovo Animal Breeding Center.

12.4. Evidence data are registered in the Register for insemination. The register is unique and contents similar data as in the paragraph 1 of this article. Data register are save at least 5 years.

### Article 13

13.1 The Ministry for assessment of a success of the artificial breeders has assigned the index of 2.0 as the lowest groundsel to the positive assessment.

13.2 The failures of the artificial insemination to inseminators licensed by the index as specified in the point 13.1 are allowed up to minus 10%.

### Article 14

### The license of the bulls for a natural insemination

Kosovo Animal Breeding Center does assessment of bulls for the natural breeding.
Assessment of the bulls is done in age of 12 monthly.

### Article 15

Kosovo Animal Breeding Center set criterions of the bull's assessments for the insemination according to race and the seed quality.

## Article 16

16.1. ABC keeps records of the bulls which are used for a natural insemination.
16.2. The register includes these data:

a) The owner of the bull and address,
b) The Identification number and race,
c) Date of birth,
d) Data on origin,
e) Date of initial test,
f) Intake date of insemination and
g) Date of retesting according to the range.

## Article 17

17.1. The owner of the bull which is used for natural insemination should keep the following data:

a) Name, surname and address
b) Date of service,
c) Number of cow identification and
d) Race.

## Article 18

18.1 Inapplicability of this administrative instruction will be sanctioned according to article 25, paragraph 25.1, point (c) and (f) of law on Kosovo livestock,
18.2 Except the punitive measures according to paragraph 1 of this article, the licence is taken out for importer of the biologic material as well as for the artificial inseminators. The licence according to the paragraph 2 of this article will also be taken away from farmers which breed animals outside their farms.

## Article 19

This administrative instruction will be enter into force upon its signature day.

Pristine, 07. 07. 2008

Ministry of Agriculture, Forestry
and Rural Development,
The Minister
Idriz Vehapi

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada – Government*

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLPJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

# REQUEST OF IMPORT OF THE INSEMINATION MATERIAL/ANIMALS

No. __/__

**Name and surname:**

**Name of subject:**

**Address:**

**Tel. Fax. E-mail:**

**Race:**

**Quantity:**

**Quantity according to the gender:** **Males:** **Females:**

**Age:** **from:** **month** **to:** **month**

**State of origin:**

**Importer:** **No of license**

**Receiver of delivery:**

**Address:**

**Date:** ___/ ___/ _________ **Signature:**_________________

**According to articles 5 points 5.2 of the Administrative Instruction MA-No. XX / 2008 attached to the request of import of the biological material must be also the breeding certificate /pedigree of animals.**

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLPJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNIG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

## REQUEST FOR IMPORTING THE INSEMINATION MATERIAL

No. __/__

Name and surname:

Name of subject:

Address:

Tel. Fax. E-mail:

Race:

Quantity:

Serial numbers: from: to:

Year of production

State of origin:

Importer: No of license

Receiver of delivery:

Address:

Date:___/ ___/ _________ signature:__________________

According to article 5 point 5.2 of the administrative instruction MA-NO. XX / 2008 the performance of the bull should be attached to the request for import of the biological material.